



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03 - 10012 dt. 04/03 2022

Në bazë të nenit 43, pika 43.1, neni 44, pika 44.1, 44.2 dhe 44.3, të Ligjit nr. 03/L-40, për vetëqeverisje Lokale, neni 6, pika, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës të anëtareve të Kuvendit të Komunës me datë 02.03.2022 dhe me nr. të protokollit: 01-070/01-9701, dhe në bazë të kërkesës të Kryetarit të Komunës të dt. 03.03.2022, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **08.03.2022**, (ditë e Marte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET

**Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës me rastin e 8 Marsit
"Dita Ndërkombëtare e Gruas"**

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. 8 Marsi "Dita Ndërkombëtare e Gruas"
 - a. Fuqizimi ekonomik i grave .
 - b. Qasja institucionale për dhunën ndaj grave.
 - c. Transporti publik dhe siguria për vajzat dhe gratë.
2. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 12-400-49872, të datës 30.09.2021

Drenas, 04.03.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-400/01-9882 dt. 03.03.2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Shkresës Nr.020-830/3, të datës 18.11.2021 të MAPL-së, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ____ 03.2022, të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e vendimit Nr.12-400-49872, të datës 30.09.2021

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës shfuqizimi i vendimit **Nr.12-400-49872**, të datës 30.09.2021, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tri (3) fushave sportive në pronën komunale, në parcelën 965-0 zona kadastrale në Nekoc, parcelën 614-0 zona kadastrale Kishnarekë, parcelën 910-0 zona kadastrale Terstenik dhe një hapësirë rekreative sportive në parcelën 410-0 zona kadastrale Gllobar, i plotësuar.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit Nr.12-400-49872, të datës 30.09.2021, i Kuvendit të Komunës së Drenasit, bazohet në raportin e MAPL-së, për vlerësimin e ligjshmërisë Nr.020-830/8, të datës 18.11.2021.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Drenasit me datë 30.09.2021 ka aprovuar vendimin Nr.12-400-49872 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tri (3) fushave sportive në pronën komunale, në parcelën 965-0 zona kadastrale në Nekoc, parcelën 614-0 zona kadastrale Kishnarekë, parcelën

910-0 zona kadastrale Terstenik dhe një hapësire rekreative sportive në parcelën 410-0 zona kadastrale Gllobar, i plotësuar, mirëpo pas vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal sipas shkresës Nr.020-830/3, të datës 18.11.2021 është rekomanduar që kur kemi parasysh që Hartat Zonale janë në procedurë të hartimit, këto lokacione të parashihen përmes këtij dokumenti, andaj me qëllim që rekomandimi i MAPL-së të inkorporohet, kërkohet që të aprovohet ky propozim vendim.

Me respekt!